

Çfarë është OICS-ja

- Ne jemi një institucion publik i pavarur, i krijuar mbi bazën e Ligjit të Imigracionit dhe Azilit të vitit 1999.
- Ne shërbejmë si rregullatorë për personat që japin këshilla për çështje të imigracionit, duke garantuar që ata të jenë kompetentë dhe të mbrojnë interesat e klientëve të tyre.
- Që nga data 30 prill 2001 konsiderohet shkelje penale kur një person ofron këshilla apo shërbime në fushën e imigracionit në rastin kur kompania e tij nuk është regjistruar pranë OISC-së, nuk ka marrë një certifikatë të posaçme nga OISC-ja që e përjashton nga ky detyrim, apo nuk e mbështet aktivitetin e vet mbi një aspekt tjetër të ligjit në fjalë.
- OISC-ja është rregullator për ofrimin e këshillave dhe shërbimeve të imigracionit.
- Ne nuk jemi rregullatorë për dhënien e informacionit të përgjithshëm për sistemin e azilit dhe imigracionit.

Si mund të gjendet një person që jep këshilla për imigracionin

- Ju mund të gjeni një këshillues për çështjet e imigracionit që është aprovuar nga OISC-ja në të gjithë vendin, duke hyrë në faqen tonë të internetit në adresën:
<http://www.oisc.gov.uk/adviser-finder/00-adviser-finder.asp>

Ankesat

- Ne trajtojmë ankesat për çdo person që ofron këshilla për imigracionin, përfshirë përfaqësues të organizmave profesionale që veprojnë në këtë fushë, si p.sh. avokatët.
- Kushdo mund të paraqesë një ankesë.
- Të gjitha ankesat do të trajtohen në mirëbesim.

Për kë shërbejmë ne si rregullatorë

- Të gjithë personat e regjistruar në OISC që japin këshilla imigracioni, duhet të tregojnë certifikatat e OISC-së.
- Certifikatat, bashkë me logon globale të OISC-së, tregojnë se organizata në fjalë i ka përmbushur standardet e OISC-së.

Për kë nuk shërbejmë si rregullatorë

- OISC-ja nuk rregullon aktivitetin e të gjithë personave që ofrojnë këshilla imigracioni.
- Përfaqësues të disa institucioneve profesionale, apo persona të mbikqyrur prej tyre, mund të ofrojnë këshilla imigracioni pa u regjistruar pranë OISC-së.
 - Këto institucione profesionale janë:
 - Shoqata e Juristëve (The Law Society)
 - Shoqata e Juristëve të Skocisë (The Law Society of Scotland)
 - Shoqata e Juristëve të Irlandës së Veriut (The Law Society of Northern Ireland)
 - Instituti i Përfaqësuesve ligjorë Ekzekutivë (The Institute of Legal Executives)
 - Këshilli i Përgjithshëm i Barristerëve (The General Council of the Bar)
 - Fakulteti i Avokatisë (The Faculty of Advocates)
 - Këshilli i Përgjithshëm i Barristerëve të Irlandës së Veriut. (The General Council of the Bar of Northern Ireland)



OFFICE OF THE
IMMIGRATION SERVICES
COMMISSIONER